



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËS SË VOTIMIT PËR KANDIDATËT PËR KËSHILLIN E BASHKISË DIVJAKË PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30 QERSHOR 2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 01.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

Shqyrtoi çështjen me,

OBJEKT: Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Divjakë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 Qershor 2019.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1 gërma "a" dhe neni 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

Me vendimin nr. 32, datë 06.03.2015 "Për miratimin e disa rregullave për regjistrimin e koalicioneve zgjedhore në KQZ", KQZ ka përcaktuar disa rregulla për mënyrën e regjistrimit të koalicioneve zgjedhore. Në përputhje me vendimin nr. 32 të KQZ, partitë politike depozituan respektivisht në KQZ marrëveshjet e tyre dhe KQZ me vendimet përkatëse ka miratuar regjistrimin si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, dy koalicione zgjedhore, Koalicionin Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE) dhe Koalicionin Shpresa për Ndryshim (SHN).



Nr. 776 i vendimit Data 01.06.2019 e vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Divjakë , për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

Brenda afatit të përcaktuar në nenin 67, pika 1 dhe pika 2 të Kodit Zgjedhor, 6 (gjashtë) parti të Koalicionit Aleanca për Shqipërinë Europiane (ASE), 1. Partia Socialiste e Shqipërisë, 2. Partia Social Demokrate e Shqipërisë, 3. Partia Demokracia Sociale, 4. Partia e Unitetit Kombëtar, 5. Partia Aleanca për Barazi e Drejtësi Europiane, 6. Partia Socialiste e Moderuar, kanë depozituar kërkesat për regjistrim listash shumemërore për kandidat për Këshillin e Bashkisë Divjakë. Gjithashtu ka depozituar listën shumemërore 1 (një) parti e cila kandidon më vete, 1. Partia Bindja Demokratike.

Në përfundim të procesit të regjistrimit të listave shumemërore, KQZ në mbështetje të nenit 98, pika 3 dhe 4, Udhëzimit nr. 3, datë 04.03.2015 organizoi shortin për përcaktimin e renditjes së subjekteve zgjedhore në fletën e votimit për kandidatët për këshillat, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019. KQZ me vendimin nr.726, datë 30.05.2019, miratoi rezultatin e shortit duke përcaktuar numrin rendor që do të ketë cdo subjekt zgjedhore në fletën e votimit.

Renditja në fletën e votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Divjakë do të bëhet sipas numrit rendor të dalë nga rezultati i shortit për partitë politike të cilat kanë depozituar lista shumemërore për këtë Bashki, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 23, pika 1 gërma "a", nenin 97, pika 2, nenin 98, pika 3, 4 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Divjakë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv.Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 776 i vendimit Data 01.06.2019 e vendimit Ora 11.00 e Vendimit

Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Divjakë , për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.